




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.527/2023
Datë: 27 nëntor 2023

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 25 par. 2 të Rregullores Nr. 15/2022 për Statusin, të Drejtat, Detyrimet, Performancën, Disiplinimin, Transferimin, Trajnimet dhe Përfundimin e Marrëdhënies së Punës së Bashkëpunëtorëve Profesional, në takimin 317-të, të mbajtur me datë 27 nëntor, merr këtë:

V E N D I M

- I. Themelohet Komisioni për trajtimin e kërkesave të Bashkëpunëtorëve Profesional për transfer të përhershëm në gjykata/degë, në përbërjen si në vijim:
 1. Fahret Vellija, anëtar i KGJK-së/kryetar i komisionit;
 2. Fidan Hoxha, anëtar i KGJK-së/anëtar i komisionit dhe
 3. Ahmet Imami, anëtar i KGJK-së/anëtar i komisionit.
- II. Vendimi hyn në fuqi me datë 27 nëntor 2023.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, vazhdimisht pranon kërkesa të bashkëpunëtorëve profesional për transfer të përhershëm nga gjykatat/degët ku ushtrojnë funksionin e tyre, në gjykata të tjera. Po ashtu, duke marr parasysh se Këshilli ka miratuar planin e punësimit për vitin 2023, me vendimin KGJK.nr.526/2023, ka shpallur shprehje të interesit për transfer të përhershëm të bashkëpunëtorëve profesional, në gjykata/degë.

Me qëllim të trajtimit të kërkesave të bashkëpunëtorëve profesional, për të vlerësuar plotësimin e kushteve për transfer, Këshilli ka themeluar Komisionin për trajtimin e kërkesave të tilla, në përbërjen si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGAJ

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Anëtarëve të Komisionit;
- Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore;
- Sekretariatit të KGJK-së dhe
- Arkivit

